

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Departamenti i Biologjisë
Programi: Biologji molekulare

Matematikë për biologji

Semestri dimëror 2024/25

Mësimdhënësi:

Dr. sc. Elver Bajrami
E-mail: elver.bajrami@uni-pr.edu

Konsultat: Luteni ta caktoni terminin me e-mail ose ne termini e shpallur nga Departamenti.

Përshkrimi:

Nocionet themelore të matematikës elementare: Bashkësitë dhe veprimet me to, numrat dhe veprimet me numra. Thyesat dhe veprimet me to. Shprehjet algebrike. Sistemi numerik decimal (me bazë 10) dhe heksadecimal (me bazë 16). Shënimi shkencor i numrit decimal. Madhësitë dhe njësitë matëse. Konvertimi i njësive matëse. Sipërfaqja dhe vëllimi. Fuqizimi dhe rrënjëzimi. Ekuacionet lineare, kuadratike dhe zbatimi i tyre. Përqindjet dhe zbatimi i tyre. Përpjesa (raportet). Funkcionet elementare me një të panjohur (funksioni linear, kuadratik, eksponencial dhe logaritmik). Jobarazimet lineare. Kuptimi i funksionit me shume ndryshore. Sistemet e ekuacioneve lineare (me dy dhe tri te panjohura) dhe zbatimi i tyre. Syprinat e sipërfaqeve (trekëndëshi, katërkëndëshi, rrethi). Trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, prizmi dhe piramida).

Objektivat:

Pas përfundimit të kursit pritet që studenti të

- Të kuptojë nocionet e problemit matematik që kërkon zgjidhje, t'i lidhë këto nocione dhe me anën e tyre të bëj zgjidhjen e problemit
- Problemet e zgjidhura të dijë t'i zbatoj në zgjidhjen e problemeve të reja
- Zbatimi i përqindjeve dhe raporteve.
- Njohja e studentëve me funksionet elementare dhe zbatimi i tyre.

Materialet mësimore:

Teksti bazë dhe literatura përcjellëse

Teksti bazë: Ramadan Limani, Kursi i matematikës elementare, Prishtinë.

Literatura përcjellëse: Isak Hoxha, Matematika, Prishtinë.
Terry H. Wesner, Harry L. Nustad: *Intermediate Algebra with applications*, WCB Group 1991.

Vlerësimi: Vijueshmëria - 10 pikë
 Provimi me shkrim ose kollukiumet – 40 pikë
 Provimi përfundimtar – 50 pikë

Provimi me shkrimi ose kollukiumet: Studentët përcaktohen për përfundimit e provimit me shkrim duke i u nënshtruar dy kollkiumeve, ku i pari mbahet në javën e shtatë të mesimit kurse tjetri në fund.

Provimi përfundimtar: Organizohet në formë testi dhe detyrave. Konsiderohet se provimi përfundimtar është i dhënë, nëse shuma e pikëve të fituara nga vijueshmëria, provimi me shkrim dhe provimi përfundimtar është të paktën 51 pikë dhe së paku studenti ka hyrë në provim përfundimtar.

Studentët do të vlerësohen sipas këtij kriteri:

<i>Pikë</i>	<i>Nota</i>
0-50	5
51-60	6
61-70	7
71-80	8
81-90	9
91-100	10

Datat e provimit përfundimtar i përcakton Departamenti i Biologjisë. Shpalljet e rezultateve dhe informatat tjera bëhen përmes ueb faqes www.ebajrami.weebly.com dhe sistemit SEMS.